



Planuar / Dorezuar Primi/Prodato Received/Delivery	30.06	2022	2	viti god year
Organ/Njësia Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKUMSHICK	3838/2022		115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova -- Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.459/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.459/2022 të datës 17.05.2022 të parashtruar nga ankuesi: _____ me adresë Rruga _____ Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit/Komuna e Skenderajt, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.459/2022 e datës 17.05.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 02-020-01-0017972/22 i datës 21.04.2022 i Kryesuesit të Komisionit të Rekrutimit.

A r s y e t i m

Komuna e Skenderaj, më datë 19.01.2022 ka bërë njoftimin se konkursin për vendin e punës "Arkëtar 3", do të hapet për aplikim nga data 09.02.2022 gjer më datën 23.02.2022, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili nga Njësia e Burimeve Njerëzore në bazë të vlerësimit paraprak të aplikacioneve është përfshirë në listën e shkurtër, dhe është ftuar të merr pjesë në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Pas vlerësimit të testit me shkrim, intervistës me gojë dhe jetëshkrimit, në bazë të renditjes përfundimtare të kandidatëve ka marr gjithsejtë 65.68 pikë, ku me datë 14.04.2022 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me njoftimin me numër 02-112-01-0016359/22 i ka njoftuar kandidatët lidhur me rezultatet e vlerësimit për vendin e punës "Arkëtar 3".

Ankuesi i pa kënaqur me njoftimin e datës 14.04.2022 ka parashtruar ankesë në organin e punësimit i cili me datë 21.04.2022 ka marrë vendimin me numër 02-020-01-0017972/22 me të cilin vendim është refuzuar si e pa bazuar ankesa e ankuesit Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin e datës 21.04.2022 me datë 17.05.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 2870/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 24.05.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Skenderaj. Me datë 03.06.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Skenderajt me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 17.05.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 21.04.2022 i Kryesuesit të Komisionit; Kërkesa e datës 13.01.2022 për zhvillimin e procedurave të rekrutimit; Vendimi i datës 17.01.2022 mbi lejimin e shpalljes së konkursit; Njoftimi i datës 14.04.2022; Njoftimi i datës 08.03.2022; Konkursi i datës 09.02.2022; Vendimi i datës 15.03.2022 për emërimin e anëtarëve të Komisionit; Përgatitja profesionale, përvoja e punës dhe certifikatat e ankuesit Përgatitja profesionale, përvoja e punës dhe certifikata për kandidaten e përzgjedhur Renditja përfundimtare e kandidatëve si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi ka aplikuar në konkursin me numër referencë RN00008111, me emrin e grupit „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm” për pozitën “Arkëtar 3”, në Drejtorin për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, e shpallur nga Komuna e Skenderajt sipas njoftimit datës 19.01.2022 për aplikim nga data 09.02.2022 deri me datë 23.02.2022, në të cilën procedurë ankuesi ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale, sepse organi i punësimit nuk i ka njoftuar kandidatët se me sa pikë janë vlerësuar në testin me shkrim, intervistën me gojë dhe të jetëshkrimit, ankuesi më tej pretendon se CV e tij është më e mirë se e kandidatëve tjerë po ashtu ankuesi pretendon se CV e tij është vlerësuar me 9.8 pikë ndërsa është dashtë të vlerësohet me 20 pikë.

Sipas konkursit me numër reference RN00008111, me emrin e, e shpallur nga Komuna e Skenderajt RN00008270, sipas njoftimit të datës 19/01/2022, i shpallur me datë 09.02.2022, për grupin „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm” për pozitën “Arkëtar 3”, në Drejtorin për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, në Komunën e Skenderajt, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- Diplomë/a e shkollës së mesme apo ekuivalente me to,

- *Kualifikime të posaçme formale: Nuk ka;*
- *Përvoja e punës: Nuk kërkohet". Ndërsa dokumentet që duhet të paraqitur për aplikim janë: "Kopja e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; Kopja e dëshmisë së punësimit; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve".*

Në bazë të dokumentacionit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se sipas aplikacionit të ankuesit dhe kandidatës së rekomanduar, të dy kandidatët kanë plotësuar kushtet e konkursit, duke poseduar dëshmitë e përgatitjes profesionale, dëshmitë e përvojës së punës, dhe certifikatat e trajnimeve, në këtë rast edhe verifikimi paraprak që këta kandidatë kanë plotësuar kushtet e konkursit është vlerësim i drejtë, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderajt ka vepruar në pajtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se gjatë këtij procesi ka pasur shkelje procedurale sepse tek jetëshkrimin është vlerësuar me 9.8 pikë është dashur të vlerësohet me 20 pikë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të nenit 22 paragrafit 1, 2 dhe 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, që ka përcaktuar se: *"1.Pas testimit me shkrim, vlerësimi i kandidatëve vazhdon me vlerësimin e jetëshkrimit. 2.Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit. 4.Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri në njëzet (20) pikë, të ndara, si vijon: 4.1. deri në tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin të arsimimit; 4.2. deri në shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë; dhe 4.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet"*, ndërsa Komisioni i Vlerësimit në bazë të dokumentacioneve ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit për kandidatët ku ankuesi është vlerësuar me gjithsejtë 9.8 pikë, ndërsa kandidatja e rekomanduar është vlerësuar me 12 pikë, në këtë rast pretendimi i ankuesit është i pabazuar sepse vlerësimi për këtë pjesë është bërë në mënyrë të drejtë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me poentimin e tij dhe mos njoftimin e pikëve nga ana e organit të punësimit, Kolegji ka konstatuar se poentimi i të gjithë kandidatëve si në testim me shkrim po ashtu edhe në intervistën me gojë, bëhet përmes sistemit elektronik/Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe se ankuesi nga testimi me shkrim ka realizuar gjithsej 53 pikë ndërsa nga intervistimi me gojë ankuesi është vlerësuar me 2.88 pikë, bazuar në nenin 21 paragrafi 3 dhe 4 i Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka përcaktuar se: *"3.Testi me shkrim zhvillohet dhe vlerësohet në mënyrë elektronike. 4.Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur nga testimi me shkrim, jetëshkrimi dhe intervistimi me gojë ka grumbulluar gjithsej 73.8 pikë dhe është renditur e para në listën përfundimtare ndërsa ankuesi nga testimi me shkrim, jetëshkrimi dhe intervistimi me gojë është renditur i dyti në listën përfundimtare me gjithsej 65.68 pikë andaj bazuar në dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafit 11 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ka përcaktuar se: *"Në përfundim të vlerësimit, kandidatët e vlerësuar me 70 për qind apo më shumë, të pikëve totale të vlerësimit, konsiderohen kandidatë*

fitues dhe renditen nga Komisioni i pranimit, sipas pikëve të marra, në listën e kandidatëve të suksesshëm (në vazhdim: Lista e kandidatëve), e cila publikohet në ueb faqe".

Kolegji, po ashtu ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt me datë 14.04.2022 ka publikuar Rezultatet e vlerësimit respektivisht listën përfundimtare të kandidatëve me numër protokolli 02-112-01-0016359/22 për grupin „Specialist i Administrimit te Përgjithshëm“ për pozitën “Arkëtar 3”, në Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, në Komunën e Skenderajt, duke listuar lidhur me rezultatet përfundimtare një kandidat me mbi 70 pikët e arritura, dhe se si kandidate e suksesshme është përzgjedhur znj. [] që ka arritur gjithsejtë 73.8 pikët e përgjithshme, andaj Kolegji konstaton se publikimi është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është theksuar se: **2. Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues..**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar deshmite e ofruara dhe ka konststuar se Komisioni i Pranimit me rastin e përzgjedhjes së kandidates [] për grupin „Specialist i Administrimit te Përgjithshëm“ për pozitën “Arkëtar 3”, në Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim , në Komunën e Skenderajt, si kandidatja e cila ka grumbulluar me së shumti pikë gjithsejtë 73.8 pikët e përgjithshme, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: “... nenin 24. **Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në se cilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit**”, ndërsa sa i përket vlerësimit te arsimimit kandidatja e përzgjedhur posedon Diplomë me numër 957/14 të datë 19.08.2014, lëshuar nga Kolegji AAB me të cilin dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore universitare ne programin Menaxhment dhe informatike me date 25.06.2014 dhe ka marr titullin Bachelor në Menaxhment dhe Informatikë si dhe Diplomë me numër 726 të datës 14.06.2004, lëshuar nga Shkolla e Mesme Teknike „Anton Çeta“ në Skenderaj, me të cilin dëshmohet se ka përfunduar Shkollën e Mesme Teknike ne profilin „Teknik Ekonomie“.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Zyra e Personelit e Komunës së Skenderajt me rastin e publikimit të Rezultateve të vlerësimit respektivisht listës përfundimtare të kandidatëve me numër protokolli 02-112-01-0016359/22 për grupin „Specialist i Administrimit te Përgjithshëm“ për pozitën “Arkëtar 3”, në Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, në Komunën e Skenderajt, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu konstaton se Komisioni i Pranimit me rastin nxjerrjes se Vendimit me numër protokolli 02-020-01-0017972/22 te datës 21.04.2022 me te cilin ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit Isa Osmanaj ka vepruar ne pajtim me dispozitat Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse është vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se procedura e konkursit sipas njoftimit të datës 19/01/2022, e shpallur me datë 09.02.2022, për grupin „Specialist i Administrimit të Përgjithshëm” për pozitën “Arkëtar 3”, në Drejtorin për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, e shpallur nga Komuna e Skenderajt, me numër reference RN00008111, është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.


Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.459/2022

Valentina Kaçandolli Bektashi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Skenderajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.